

LASER 480 SC

PRODUKT PËR MBROJTJEN E BIMËVE
"KLASA 3". Xi.



"KUJDES". "IRRITUES". I RREZIKSHEM PER MJEDISIN-N.

Laser 48 SC është insekticid me baze Spinosadi, një lende aktive e re e ekstraktuar nga kolonite bakteriale te *Saccharopolyspora spinosa*, një bakter që gjendet i pranishëm në natyrë. Është insekticid me verpim kontakt dhe ngrenie, me veprim parambrojtes dhe kurues, në luftimin e insekteve të klasave lepidoptera, diptera, siphonaptera, thysanoptera dhe disa koleoptere në kultura të ndryshme. Spinosadi vepron në sistemin nervor qendror të insekteve, duke shkaktuar një paralizë të pa kthyeshme, e cila shkakton ngordhjen e insekteve në krye të tre diteve.

Lenda vepruese: 48% *Spinosad*
Formulimi: *Koncentrat i suspendueshem (SC)*
Pamja: *Leng me ngjyrë kashtë.*

Masat parambrojtese:

- Mbajeni në vende të sigurta dhe të pa aritëshme nga femijet.
- Ruajeni në vende të thata dhe të fresketa, larg ushqimeve dhe pijeve për njerëzit si dhe ushqimeve për blegtorinë.
- Evitoni kontaktet e zgjatura të syve dhe lekures me preparacionin.
- Evitoni marrjen e preparatit me organet e frymemarrjes gjatë përgatitjes së solucionit për spërkatje dhe gjatë spërkatjes.
- Gjatë përdorimit të tij mos ha e mos pi ujë dhe duhan.
- Gjatë punës përdor paisje mbrojtëse: kominoshe, doreza, maska, syze.
- Në perfundim të punës, lani paisjet mbrojtëse, mjetet spërkatëse, duart dhe pjesët e tjera të ekspozuara të trupit.
- Asgjësimi i ambalazheve të bëhet sipas rregullave në fuqi.

Udhëzime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast kontakti me lëkurën, hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të pastër dhe me sapun me ujë të bollshëm dhe sapun.
- Në rast kontakti me sytë, i lani menjëherë me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe kërkoni këshillë mjekësorë.
- Në rast se nuk ndiheni mirë, ndaloni punën dhe kërkoni ndihmë mjekësore.
- Në rast gjëllitje, provokoni artificialisht të vjella dhe kërkoni ndihmë mjekësore. Jepini të aksidentuarit karbon aktiv, kur nuk ka humbur ndjenjat.
- Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik.

Përdorimi:

Molle, dardhe: për kontrollin e krimbit të molles, tenjes së molles dhe minatrices (*Lithocolletis blancardella*); doza e përdorimit 20-30 gr/100 lit ujë, duke kryer jo më shumë se 3 trajtime gjatë një vegjetacioni. Për kontrollin e pleshtit të dardhes, me doze 30-35 gr/100 lit ujë.

Pjeshke, kumbull, nektarine, qersh: për kontrollin e anarsias, cidias dhe tripseve (*Thrips major*, *Thrips meridionalis*, *Frankliniella occidentalis*), me doze 20-30gr/100 lit ujë.

Vreshte: për kontrollin e tenjes; spërkatja bëhet në breznin e dytë ose të tretë dhe përsëritet 7-10 ditë. Doza e përdorimit 10-15 gr/100 lit ujë. Për kontrollin e tripsit (*Frankliniella occidentalis*), spërkatja bëhet në fazën e 10-20 % të lulëzimit, kur ka 1-2 tripse në gjendje lëvizëse, me doze 20-25 gr/100 lit ujë.

Domate, spec, patelxhan, trangull dhe lule shtrydhe në sera: për kontrollin e tripsit (*Frankliniella occidentalis*), me doze 20-25 gr/ 100 lit ujë; për kontrollin e tenjes së domates (*Tuta absoluta*), me doze 20-

25 gr/100 lit uje; *Lyromiza spp.*, me doze 50-75 gr/100 lit uje; per kontrollin e *Spodoptera spp.*, *Heliothis* dhe te lepidoptereve te tjere, me doze 25-30 gr/100 lit uje.

Patate: per kontrollin e buburecit, me doze 50 gr/100 lit uje.

Verejtje per perdorimin:

Doza e perdorimit eshte ne vartesi te shkalles se infeksionit. Rekomandohet te mos kryhen me shume se tre trajtime per sezon. Ne rastet e kryerjes se trajtimeve te njepasnjeshme me Laser, ato nuk duhet te jene ne interval me te gjate se 7-10 dite.

Ne domate e trangull ne sera: per kontrollin e *Liromyza spp.*; nese shtohen vajra parafinike me 300 gr/100 litra uje, LASER 48 SC mund te reduktohet ne dozen 35-50 gr/100 lit uje.

Perdorimi ne kombinim me vajra te parafinuara, me doze 250 gr/100 lit uje, eshte gjithashtu i efektshem ne luftimin e morrave pambukore ne kultura te ndryshme.

Produkti i reziston shplarjeve nga rreshjet 4 ore pas trajtimit. Ne qofte se bien rreshje pas 4 oreve, sperkatja duhet te perseritet.

Ndikimi ne ekosistem:

Mesatarisht helmues per gjitaret). Mesatarisht helmues per zogjte. Helmues per bletet, prandaj nuk duhet te trajtohet ne kohen e lulezimit dhe ne oret e mesdites kur eshte aktiviteti me i madh i bletes. Mesatarisht helmues per peshqit. Helmues per jovertobroret ujore. Mos ndotni ujrata dhe basenet ujore me produktin ose ambalazhin e tij.

Karenca

Molle, dardhe, kumbull, pjeshke, nektarin, patate 7 dite. Domate, spec, trangul, patelxhan 3 dite. Lule shtrydhe 1 dite.

Magazinimi:

Ruhet ne vende te thata, te ajrosura, te erreta, ne ambalazhin original, ne temperatura deri 35 grade C.

Nr dhe data e regjistrimit: 367, date 29.12.2010;

Sasia neto e PMB-se, qe ndodhet ne ambalazhin baze: 10, 20, 50, 100 ml.

Data e prodhimit..... ;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kerkeseva të përcaktuara): 2 vjet;

Numri i partise se mallit (serise) ose shenja te tjera identifikuese ;

Tipi i ambalazhit baze: shishe HDPE (High density polyethylene).

Emri dhe adresa e Aplikantit: Corteva Agriscience International Sàrl. Adresa: Versoix, Zvicër;

Emri dhe adresa e fabrikuesit te PMB-se: Corteva Agriscience International Sàrl. Adresa: Versoix, Zvicër;

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet ne Republiken e Shqiperise):